



SHPALLJE PUBLIKE

AKP e cila ka në Administrim të Drejtpërdrejtë Ndërmarrjen Shoqërore “Inex Sharr Planina ” Brezovicë

SHPALLË këtë:

FTESË PËR OFERTË

I. LËNDA E KONTRATËS

a) Shpallje publike për blerjen autobus të udhëtarëve

Me qëllim të transportimit të punëtorëve në qendrën e skijimit në Brezovicë, AKP shpall tenderin për blerjen e autobusit të udhëtarëve për nevoja të Ndërmarrjes.

b) Kërkesat teknike për blerjen e autobusit përfshijnë:

Kushtet e përgjithshme për pjesëmarrje në ftesën publike për blerjen e autobusit: duhet bashkëngjitur hollësitë e detajuara të automjetit gjatë konkursit me fotografi, dokumente shoqëruese të nevojshme sa i përket gjendjes ligjore dhe teknike.

Komisioni do t'i vizitojë automjetet që ofrohen për shitje sipas ftesës:

Autobusi

- Deri në 55 ulëse,
- jo më i vjetër se i vitit 2001
- Në gjendje të mirë fizike
- Garancioni i punës 4 muaj

Kriteret e notimit do t'i përpilojë komisioni. Komisioni do ta vlerësojë gjendjen dhe kilometrat e kaluara si prioritet.

c) Kërkesat teknike për operatorin ekonomik:

Duhet të ofroj garancion së paku 4 muaj për autobus

Periudha e dorëzimit të ofertave 7 ditë nga data e shpalljes.

Operatori ekonomik fitues do të shpallet ai i cili i plotëson kriteret teknike dhe oferton me çmimin më të ulët.

Buxheti maksimal i lejuar për këtë aktivitet është 13,000.00 €.

d) Oferta duhet të përmbajë

1. Formularin e kuotimit të çmimit e nënshkruar,
2. Certifikatën e regjistrimit të biznesit (nëse është biznes),
3. Çmimin e ofruar me TVSH (nëse është biznes),
4. Nr. i telefonit kontaktues dhe adresa.



AFATI KOHOR DHE VENDI PËR DORËZIMIN E OFERTAVE

Për tu njohur më afër me aktivitetin që do të kryhen Operatorët ekonomik mund të bëjnë vizitë te Qendra e Skijimit në Brezovicë çdo ditë punë nga data 13.02.2025 deri më 19.02.2025.

Ofertat finale të cilat duhet të jenë në zarf të mbyllur, duhet të dërgohen më datën **20.02.2025** nga ora **10:00** deri në orën **11:00** në adresën e mëposhtme:

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. Dritan Hoxha nr. 55, 10000 Prishtinë.

Ofertat do të hapen me datën **20.02.2025** në ora **11:10** në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, rr. Dritan Hoxha nr. 55, 10000 - Prishtinë .

V. Përfaqësuesit legjitim të ofertuesve, mund të marrin pjesë me rastin e hapjes së ofertave.